

Znj.Irma Qosja, mban detyrën e Avokatit të Shtetit pranë Zyrës së Përfaqesimit Ligjor në Gjykatat Kombëtare në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit. Ajo lindi në Krujë më 6 nëntor 1982.

Në vitin 2005 u diplomua juriste në Fakultetin e Drejtësisë – Universiteti Tiranë. Në periudhën 2007-2016 ka ushtruar detyrën e sekretares gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në muajin nëntor 2016, Znj.Irma Qosja, emërohet në pozicionin e Avokatit të Shtetit duke e ushtruar këtë detyrë në vazhdim.

Znj.Qosja është e pajisur me licensë avokatie nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Gjatë aktivitetit të saj profesional ka kryer një sërë trajnimesh dhe specializimesh pranë organizatave dhe entiteteve të ndryshme vendase në fushën e të drejtës së brendshme.

Znj. Qosja është zotëruese e gjuhës angleze si dhe ka njohuri të gjuhës italiane.